



Ndal Punës së Fëmijëve

**Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias**

Dramatizimi

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Objektivi: Puna përgatitore për të vënë në skenë një pjesë teatrale për punën e fëmijëve.



Përfundimi: Të nxitet të shprehurit interpretues që për të rinjtë është një shprehje e fuqishme, nëpërmjet së cilës ata pasqyrojnë, në mënyrë të fortë dhe domethënëse, atë që mendojnë. Gjithashtu, është një pikënisje e mirë për përfshirjen dhe ndëgjegjësimin e komunitetit.

Koha

6 orë mësimi, si dhe koha e duhur për provat dhe shfaqjen.



Shënim për përdoruesin

Ky modul është integrim i tri moduleve të mëparshme: “Figura”, “Loja me role” e “Shkrimi krijues” dhe mbështetet në atë që grupi ka mësuar dhe ka përjetuar emocionalisht gjatë modulit të figurës, në atë që ka mësuar në modulën e shkrimit krijues, si dhe në parapërgatitjen për të luajtur teatër si është praktikuar në modulën e lojës me role. Është mirë të mos ta zhvillojë këtë modul shumë shpejt ose të paktën pa kaluar tri modulet e sipërpërmendura.

Në disa vende adoleshentët, veçanërisht meshkujt, e kanë shumë të vështirë të interpretojnë, pasi shqetësohen shumë për figurën që do të bëjnë para bashkëmoshatarëve të tyre, veçanërisht kur nuk kanë patur përvoja të tjera në interpretim. Në përballjen dhe kapërcimin e këtyre vështirësive psikologjike, duhet të jeni shumë të kujdesshëm dhe të keni takt. Me qëllim që kjo gjë të zhvillohet sa më mirë, duhet të hyni në psikologjinë e të rinjve dhe të arrini që nxënësit ta kthejnë në shqetësimin e vet punën e fëmijëve. Mbi këtë bazë, shfrytëzoni dhe të shkruarit krijues, në mënyrë që të rinjtë të shprehin me shkrim atë që ndjejnë.

Motivimi



Studimet kanë treguar se zhvillimi i aftësive për të mësuar të interpretosh gjenden në natyrën e interpretimit teatror. Duke ndjekur udhëzimet e këtij moduli, të rinjtë do të kenë një përfytyrim të ri të jetës, të vetvetes dhe do të mësojnë:

- Të tërhiqen nga fabula që kanë krijuar;
- Të futen me fantazi në një situatë imagjinare;
- Të njohin dhe të përjetojnë rrethanat, dilemat dhe pasojat e veprimeve të personazheve të krijuara dhe rrjedhojat përkatëse;
- Të riinterpretojnë gjithçka nëpërmjet personalitetit të vet.

Thelbi i lojës dramatike është ndërtimi i një historie nëpërmjet interpretimit. Përpunimi i historisë të shpie drejt një problemi, një seri veprimesh dhe ngjarjesh që ndërtohen rreth një teme (një pikënisje për të mbajtur qëndrim). Në këtë rast, tema është puna e fëmijëve.

Në modulën e lojës me role nxënësi ka filluar të bëjë të vetat ndjenjat e fëmijës që punon. Paralelisht, moduli i shkrimit krijues ka përgatitur terrenin për të krijuar një skenar. Nëpërmjet vënies në jetë të një pjese, pra vënies në skenë të një historie të krijuar dhe të interpretuar nga të rinjtë, nga këndvështrimi i tyre, mendojmë se sillet një dozë e kënaqshme e zotërimit dhe e përgjegjësisë në raport me projektin.

Ky modul është shprehje e një niveli të ri të pjesëmarrësve në raport me procese emocionale dhe personalizimin e problemit. Nëpërmjet dramatizimit, të rinjtë do të pajisen me instrumente të reja për të shprehur emocionet. Thelbi i dramatizimit është historia, e thënë ndryshe, krijimi i një bote ireale, ku në kushte të caktuara, personazhe të caktuara përjetojnë gjendje të caktuara. Të rinjtë e grupit do të luajnë personazhe të ndryshme të historisë. Nëpërmjet punës për të nxjerrë rolin, ata do të karakterizojnë tiparet e personazhit, duke përvetësuar karakteristikat e tij fizike, emocionale dhe intelektuale. Në dramatizim veprimi lind nga bashkëveprimi i personazhit ireal dhe situatës në të cilën ndodhet. Tri kërkesat e shfaqjes

(kush?, çfarë? dhe kur?) paraqiten nga personazhi, nga veprimi dhe koha, ndërsa kërkesa “Ku?” jepet nga elementet hapësinore, pra shfaqja jepet diku.

Dramatizimi përbën një formë cilësore të veçantë të të mësuarit. Ai të krijon mundësi të arrish në një përmasë të paarritshme. Është e natyrshme që në një shoqëri të ndërthurur, si shoqëria jonë, mosrespektimi i të drejtave të njeriut, siç është edhe puna e fëmijëve, nuk mund të quhet si diçka që nuk na takon dhe që ndodh jashtë nesh, diku. Duhet të ndryshojë qëndrimi dhe të kuptuarit ndaj dukurisë së punës së fëmijëve në të gjitha vendet. Në këtë kuptim, dramatizimi dhe arti janë instrumente shumë të rëndësishme të ndryshimit.

Qëllimi i këtij moduli është krijimi tek të rinjtë i vetëdijes dhe nevojës që kanë për të ndryshuar. Që ky ndryshim të japë frytet e duhura, duhet të nisë nga vetë njerëzit. Dramatizimi të ndihmon të arrish në këtë vetëdije pikërisht nëpërmjet interpretimit të një historie të krijuar nga vetë të rinjtë. Nëpërmjet dramatizimit, të rinjtë përpiqen t'i tregojnë një pjese tjetër (publikut) historinë e tyre, duke nxitur kështu ndikimin zinxhir të përfshirjes dhe të ndëgjegjësimin të komunitetit.

Ç'duhet

Ashtu si dhe për modulet e tjera, materialet për këtë modul janë të kufizuara. Nuk është e këshillueshme të përdoren aparate të sofistikuara për të krijuar efektet e dritave, të zhurmave apo përdorimin e strukturave që prodhojnë muzikë. Pa dyshim, fabula që do të interpretohet, është pjesë nga jeta e një fëmije që punon, të cilit i mungojnë shumë gjëra: ai jeton dhe punon në kushte ekstremisht të vështira, prandaj një pasqyrim i jetës së tij duhet ta përcjellë këtë.

Grupi duhet të punojë me ato gjëra që ka përreth. Do të ishte fat i madh nëse grupi do të kishte një farë skene ku të punonte dhe të paraqiste punën e vet. Fillimisht grupi duhet të provojë në klasën që




ka në dispozicion. Natyra e historisë që do të dramatizojë, do të kushtëzojë edhe përdorimin e materialeve të nevojshme (nëse do të jenë të nevojshme) për shfaqjen. Në varësi edhe të kushteve klimatike, mund të punoni edhe jashtë, në një mjedis të qetë. Meqë ky modul kërkon praninë e të gjithë grupit, nuk do të jetë e nevojshme ndarja në nëngrupe etj.



Shënim për përdoruesin

Ky modul është i lodhshëm për ju dhe grupin. Gjatë punës suaj bëni pushime të herëpashershme. Të rinjtë nuk mund të përqendrohen për një kohë të gjatë, prandaj është e nevojshme të bëjnë pushim, të argëtohen, në të kundërtën mund të mos përqendrohen dhe ta drejtojnë vëmendjen e tyre diku tjetër. Duke bërë pushimet e duhura, mund të përqendrohen duke vlerësuar njëkohësisht interesimin që tregoni ju për shëndetin e tyre. Jepuni këshilla për gjendjen e mirë fizike dhe emocionale që duhet të kenë gjatë zhvillimit të këtij moduli shumë impenjativ. Është e natyrshme që nuk duhet të harroni edhe mirëqenien tuaj.

Përgatitja



Në rastet që është e mundshme dhe e nevojshme, këshillohet që të zhvilloni njëkohësisht lexime për dramatizimin si një mjet pedagogjik. Mirë është të gjeni tekste të ndryshme që flasin për dramatizimin si mjet formues, që gjenden në biblioteka të ndryshme. Nëse keni ndonjë të njohur që ka përvoja në dramatizim, kërkojini ndihmë. Gjithësesi, ju këshillojmë që për zhvillimin e këtij moduli, duhet të siguronit ndihmën e një eksperti të fushës. Edhe nëse ndieheni të sigurtë, është gjithmonë mirë të dëgjoni mendimin e një specialisti të fushës.

Ndihma e jashtme varet kryesisht nga qëllimi dhe objektivat që grupi i ka vënë vetes. Nëse dëshironi të promovoni punën në grup (dhe kështu duhet të jetë), ju dhe grupi duhet të shfrytëzoni përvojën që kanë specialistët e teatrit që mund t'ju ndihmojnë dhe në realizimin e modulit “Shkrimi krijues” dhe anasjelltas. Gjithashtu, nëse e shikoni të vlefshme, drejtojuni përsëri personave që ju kanë ndihmuar gjatë realizimit të moduleve “Shkrimi krijues” dhe “Loja me role”.

Ndërkohë, duhet mbajtur parasysh që ndihma e këtyre profesionistëve duhet të bëhet mbi baza vullnetare.

Ndihma e jashtme



Veprimtaria 1

Përgatitja e skenarit

3 orë mësimi



Në lidhje me përgatitjen e skenarit ka dy qëndrime: të parët mendojnë se skenari ndrydh lirinë e të shprehurit të të rinjve; të dytët, përkundrazi, mendojnë se u jep siguri të rinjve në skenë, veçanërisht atyre që nuk kanë patur përvoja të tilla me parë. Nga përvoja, gjatë fazës eksperimentuese është vërejtur se të rinjtë që nuk kanë përvoja në dramatizim apo i kanë të pakta ato, prania e një skenari ndihmon pjesërisht në uljen e tensionit ndërmjet tyre. Interpretimi sipas një skenari nuk paramendon që ta mbajnë mend përmendësh dhe t'i qëndrojnë besnikë atij. Në rastin tonë, të kesh një skenar, do të thotë të kesh paraprakisht diçka në dorë që mund të ndryshohet madje edhe tërësisht.


Përmbajtja e skenarit kushtëzohet nga ide dhe faktorë të ndryshëm. Skenari është historia që do të luhet në skenë. Ndodh që kjo histori është ngjarje e jetuar nga pjesëmarrësit e grupit. Mund të ndodhë që disa prej pjesëmarrësve të jenë një fëmijë që punon apo të kenë patur përvoja të tilla. Gjithashtu, skenari mund të mbështetet në ndonjë nga historitë e krijuara gjatë realizimit të modulit “Shkrimi krijues” apo në ngjarje të ndodhura gjatë realizimit të moduleve.

Qëllimi i kësaj faze është përpunimi i një subjekti të dramatizimit sipas metodës së 4 shkallëve. Në thelb, shkalla e parë është përshtatja; shkalla e dytë dhe e tretë është zhvillimi i ngjarjeve dhe e katërta mbyllja (zgjidhja). Vetë historia është kalimi nga shkalla e parë në të katërt. Le t'i kthehemi modulit të shkrimit krijues, ku do të gjeni një përshkrim të detajuar të këtij ushtrimi.

Përpunimi i subjektit

Mbi bazën e përvijës më të rëndësishme që keni përfituar deri tani, nxitini të rinjtë të shkëmbejnë ide dhe mendime rreth historisë që mund të trajtojnë, ndërmjet të cilave mund të jenë:

- **Mesazhi.** Këtu përcaktohet cili është mesazhi që të rinjtë duan t'i komunikojnë publikut: nëse dëshirojnë ta nxisin atë të ndihmojë në zgjidhjen e një problemi; nëse duan ta shikojnë atë apo duan t'i ngjallin emocione të forta.
- **Përshtatja** në rrafshin gjeografik dhe të mjedisit të punës, duke përcaktuar nëse fëmijët ndodhen në kushte që u shërbejnë të tjerëve, nëse ata janë fëmijë të rrugës, nëse vazhdojnë të shkojnë në shkollë, krahas punës.
- **Personazhet,** që mund të jenë: fëmijë që punojnë, prindërit e tyre, shokët, punëdhënësit, njerëz të huaj etj., si dhe emrat e tyre.
- **Skena e parë** lidhet me mënyrën si duhet të paraqitet.
- **Skena përfundimtare** lidhet me gjetjen e një forme si do të përfundojë historia sipas grupit, a do të përmbajë ajo ndonjë mesazh shprese etj.
- **Pjesëmarrja** ka të bëjë nëse në dramatizimin e pjesës duhet të marrë pjesë i gjithë grupi; nëse do të marrë pjesë dikush për drejtimin artistik etj.
- **Përmbajtja,** veç të tjerave, do të parashikojë nëse do të përdoret muzika, këngët apo kërcimet për ilustrimin e dramatizimit etj.



Këto janë përmbledhtasi elementet që duhet të përdoren gjatë ushtrimit të brainstormingut. Si drejtues të moduleve duhet të mbani gjithmonë parasysh qëllimin e programit të IPECU-t, ngjalljen e shpresës. Me realizimin e këtij moduli, ju dhe i gjithë grupi keni dhënë një ndihmesë të rëndësishëm në fushatën botërore të luftës për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Ky ushtrim transmeton një mesazh shprese që shërben për të shkundur dhe pjesëmarrësit, të cilëve u paraqet një tablo të jetës shoqërore, duke shfrytëzuar në shkallën më të lartë këtë mundësi që jep moduli.

Nxitini të rinjtë të hapin mendjen dhe zemrën e tyre gjatë parashtrimit të mendimeve dhe ideve. Ata do të realizojnë një punë tërësisht të tyre që do t'u japë mundësi të dëgjohen mendimet dhe idetë e tyre për një çështje të një rëndësie të madhe që u intereson të gjithë njerëzve.

Shkruajini në një dërrasë të zezë apo në tabakë letre mendimet dhe komentet e grupit. Kur të vëreni që interesi i grupit po zbehet (p.sh., shpërqendrohen), mundohuni të arrini në një përfundim. Më pas, kur të përmbliidhni mendimet që dolën, do t'u jepni të rinjve një moment qetësie.

Duhet t'i ndihmoni të rinjtë të ndërtojnë të katërta shkallët e pjesës. Merrni të gjitha masat që të gjithë pjesëtarët e grupit të jenë aktivë dhe të mos lihet mënjandë donjë prej tyre në përgatitjen e pjesës. Brenda mundësive duhet të jetë një punë e bërë në grup.

Shkrimi i pjesës



Pasi keni bërë të gjitha përgatitjet, të fillohet puna konkrete. Kjo mund të realizohet nga një grup apo nga disa nëngrupe me pak njerëz. Pjesa të përbëhet nga dialogjet ndërmjet personazheve, veprimet dhe skenat sipas subjektit që lidhin fillimin me fundin dhe në të kundërtën. Mund të ndodhë që i gjithë grupi dëshiron të marrë pjesë në këtë ushtrim, duke kërkuar nga ana juaj një aftësi shumë të mirë vëzhgimi. Fakti që të gjithë mund të duan të marrin pjesë, është një tregues i kënaqshëm, sidomos për ju. Ju këshillojmë të mbani shënim të gjitha komentet që bëhen, në mënyrë që të mos humbisni asnjë detaj apo mendim të shprehur nga të rinjtë. Është edhe më mirë nëse dy të rinj vullnetarisht tregohen të gatshëm për të mbajtur shënime.

Në rastet kur grupi është i madh (më shumë se 10 veta), është mirë të ndahet në nëngrupe me të vogla me 2-5 veta, ku secilit t'i caktohen detyra të veçanta. Ka forma të ndryshme për organizimin e punës. P.sh., një formë është kur një nëngrup merret me krijimin e personazheve të pjesës, nëngrupi tjetër me hartimin e fillimit të pjesës, tjetri me zhvillimin e pjesës e kështu me radhë. Një mënyrë tjetër është të kërkoni nga secili nëngrup të krijojë të gjithë historinë e pjesës nga fillimi deri në fund dhe në këtë mënyrë do të keni të zhvilluara shumë histori. Kjo mënyrë është shumë interesante, pasi të gjithë së bashku në fund do të përpiqen të përfshijnë pjesë të secilit nëngrup deri sa të krijojnë historinë që të rinjtë do të mendojnë se është më e mira. Mos harroni se dramatizimi duhet të jetë fryt i punës së të rinjve, pasi duhet të jetë historia që ata dëshirojnë të tregojnë. Në këtë mënyrë rritet besimi i të rinjve në mundësitë e tyre.



Pavarësisht si janë vendosur blloqet që përbëjnë historinë e pjesës, do të vijë koha që ato duhet të latohen në mënyrë që të qëndrojnë njëri mbi tjetrin për të ngritur ndërtesën që do të jetë pjesa teatrale. Gjatë zhvillimit të këtij ushtrimi do të shikoni se me kalimin e kohës, të rinjtë do të japin ide origjinale dhe mendime rreth ndërtimit të skenave që janë me të vërtetë ambicioze. Edhe një herë, përvoja ka treguar se pavarësisht sa ambiciozë janë të rinjtë, kjo nuk i pengon ata në vënien në skenë të pjesës. Vetë grupi ka shkruar pjesën dhe ai është në gjendje të interpretojë dhe të përcjellë me realizëm dhe përgjegjësi mesazhin e saj nëse mbështetet fuqimisht edhe nga ju.

Sesioni i draftit përfundimtar

Gjithësesi, qëllimi i këtij ushtrimi nuk është të krijojmë një kryevepër skenike që do të lërë pa gojë profesionistët e teatrit, (edhe pse nuk mund të thuash asnjëherë kurrë). Qëllimi kryesor i modulit të dramatizimit është të forcojë procesin pedagogjik dhe të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit të të rinjve për praninë e domethënien e punës së fëmijëve. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i dramatizimit është se pjesa do të shfaqet disa herë, duke forcuar kështu ndikimin e mesazhit që përcjell.

Gjatë seancës përfundimtare të rinjtë duhet të ngjizin gjithë historinë e pjesës sipas ngjarjeve, personazheve dhe kushteve ku veprojnë. Gjithashtu, duhet të parashikojnë nëse ka hapësirë për muzikë, këngë apo kërcim. Vëmendja kryesore të përqendrohet në përcjelljen e mesazhit që ka



vendosur grupi. Gjithashtu, bëni kujdes që personazhet të përdorin gjuhën e bashkëmoshatarëve. Një personazhi i ri në moshë, të përdorë të njëjtën gjuhë që përdorin dhe kuptojnë të rinjtë e grupit. Fjalët që përdorin, të përcjellin emocione të vërteta, ato emocione që përjetojnë të rinjtë e moshës së grupit. Në këtë ushtrim ju keni një rol mbështetës dhe konsultues. P.sh., nëse një skenë nuk lidhet ashtu siç duhet me atë të mëparshmen, duhet të flisni me grupin, duke e ndihmuar të gjejë zgjidhjen e duhur.

Gjatë zhvillimit të kësaj seance, ndihma e njerëzve të jashtëm mund të jetë shumë e dobishme. Një dramaturg apo një shkrimtar mund t'i ndihmojë shumë të rinjtë të përmirësojnë tekstin apo konfliktet. Gjithësesi, duhet të mbani në mendje se qëllimi i këtij ushtrimi nuk është cilësia e skenarit në vetevete, por i gjithë procesi i përpunimit të skenarit dhe pjesëmarrja e grupit. Gjatë zhvillimit të këtij ushtrimi, grupi juaj mund të zhvillojë forma të ndryshme skenari. Gjithçka varet nga përbërja e grupit, nga numri i personave në grup, nga lloji i mesazhit që kërkojnë të përcjellin, nga vendndodhja gjeografike, nga kultura dhe traditat lokale. Kështu, p.sh., grupi mund të krijojë:

- Një skenar që përfshin të gjithë antarët e grupit;
- Një skenar që përfshin pjesën më të madhe të grupit, ndërsa të tjerët, ata që mbeten, merren me shoqërimin muzikor të pjesës apo me organizmin e punëve pas perdes;
- Një skenar që interpretohet me gjeste, pra pa fjalë;
- Realizimi i disa skeçeve që interpretohen nga vetë autorët apo nga të tjerët;
- Një këngë që këndohet nga i gjithë grupi ose nga disa persona;
- Një skenar me një ose dy personazhe kryesore.

Mundësitë janë të pafundme, por gjëja më kryesore është që këto interpretime janë fryt i punës së përbashkët të grupit, anëtarët e të cilit ndiehen autorë të saj me të gjithë kuptimin e fjalës.

Muzika, ashtu si teatri, kapërcen të gjitha pengesat, duke forcuar njëkohësisht identitetin kulturor. Në këtë kuptim, mund të përdoret me shumë vlerë në programin SCREAM. Grupi juaj mund të fusë këngë, muzikë apo kërcime.

Gjithçka varet nga dëshirat që kanë të rinjtë, nga prania e telenteve në muzikë dhe nga fakti që kanë apo jo instrument muzikor. Lërinë dorë të lirë grupit të vendosë vetë se çfarë do të bëjë.

Nga ky moment, grupi është i gatshëm të kalojë në interpretimin e pjesës. Koha që do t'ju duhet për përgatitjen e shfaqjes, varet tërësisht nga vendimet që do të marrë grupi sipas objektivave që ka vendosur gjatë këtij ushtrimi.

- Pjesa do t'i paraqitet të gjithë grupit apo vetëm nëngrupit?
- Do të shfaqet vetëm para shkollës apo në të gjitha shkollat e zonës?
- Do të shfaqet për komunitetin e zonës apo edhe për komunitete të tjera?
- Do të shfaqet në një sallë teatri, në sallën e shkollë apo jashtë?
- Do të shfaqet në një konkurs të teatrove të shkollave?
- Do të shfaqet vetëm një herë apo shumë herë përpara shikuesve të ndryshëm?
- A do të ftohen mjetet e komunikimit në shfaqje?


Pra, përse më sipër, gjithçka varet nga vendimet që do të marrë grupi, të cilat, edhe ato, kushtëzohen nga mjetet që kanë në dispozicion si materiale, ashtu dhe financiare, nga mbështetja që mund të sigurojnë dhe gatishmëria që do të tregojnë persona të ndryshëm për t'i ndihmuar. Të gjitha variantet janë të mundshme, por këtu duam t'ju tërheqim vëmendjen në faktin se dramatizimi është një mjet shumë i mirë në duart tuaja që shërben për të rritur ndëgjegjësimin e të rinjve ndaj problemit të punës së fëmijëve. Vlerësoni drejt të gjitha mundësitë që ju ofron ky ushtrim dhe përdorini ato në të mirë të të rinjve. Ata mund të përfitojnë shumë nga zhvillimi i këtij ushtrimi, veçanërisht në planin e rritjes dhe të zhvillimit vetjak dhe shoqëror. Vendimet dhe sjelljet e të rinjve ndikohen shumë nga zhvillimi i këtij ushtrimi. Në këtë kuptim, edhe fushata botërore kundër punës së fëmijëve do të ketë përfitimin e vet pozitiv.

Ndarja e roleve

Të gjithë pjesëmarrësit duhet të japin mendimin e tyre në ndarjen e roleve. Mësuesi mbetet në rolin e konsulentit që zgjidh situata e krijuara. Pas përvojës që keni krijuar në realizimin e modulit të lojës me role, në këtë pikë të zhvillimit të modulit të dramatizimit ju keni një ide të qartë të pikave të forta dhe të dobta të grupit.

Shënim për përdoruesin

Lëreni grupin të vendosë vetë për shpërndarjen e roleve. Është e vështirë të caktosh kush do të marrë rolet negative, pasi asnjërit nuk i pëlqen të interpretojë një personazh të keq dhe mizor. Për t'i paraprirë zgjidhjes së këtij problemi, është mirë që qysh në fillimet e shkrimit të pjesës të mendohet se kush mund ta interpretojë secilin personazh. P.sh., në pjesë mund të përdoren emrat e vërtetë të personazheve. Kështu, nëse grupi është i mendimit se, p.sh., Mira mund të interpretojë shumë mirë një personazh të caktuar dhe ajo e pranon ta luajë këtë personazh, emri i tij mund të jetë shumë mirë Mira edhe në pjesë. Në këtë mënyrë bëhet më e thjeshtë edhe të mësuarit e tekstit apo të lëvizjeve në skenë. mirëqenien tuaj.



Veprimtaria 2

Dramatizimi

2 orë mësimi dhe koha për zhvillimin e provave

Ndoshta pjesa më e madhe e pjesëtarëve të grupit tuaj nuk ka patur ndonjë përvojë të mëparshme teatrale. Do të jeni më të vertetë me fat nëse ndonjëri prej tyre të ketë patur një përvojë të tillë. Për këtë arsye është e nevojshme që të rinjtë të zhvillojnë disa ushtrime dramatizimi, pasi në këtë mënyrë do ta kenë më të lehtë për të kapërcyer ndrojtjen që është një ndjenjë krejt e natyrshme në të tilla raste. Kjo është arsya që ju këshillojmë të zhvilloni më parë modulën e lojës me role. Qëllimi është t'i bëni të rinjtë të ndiehen mirë, të veprojnë natyrshëm dhe pa ndrojtje, të mësohen me reagimet dhe opinionet e shokëve dhe të ndiehen më të sigurtë.

Ushtrimet e dramatizimit përdoren para se të fillojnë provat e vërteta, si ushtrime nxemje. Nëse keni ndihmën e një profesionisti të teatrit, ai mund t'ju ndihmojë në realizimin e një sërë ushtrimesh që do të mundësojnë krijimin e një gjendjeje shpirtërore të përshtatshme për të hyrë në thelbin e personazhit që do të interpretojnë.

Në shtesën 1 të modulit “Loja me role” do të gjeni ushtrime dhe lojëra të tilla.

Ushtrimet janë të shumta dhe i shërbejnë të njëjtit qëllim. Ju këshillojmë që një orë mësimi ta shpenzoni më realizimin e këtyre ushtrimeve që është një fazë përgatitore para provave të teatrit.

Puna me një grup të rinjsh për të bërë një shfaqje teatri, është shumë impenjative, në të njëjtë kohë shumë e këndshme. Mënyra si do të vendosni për të bërë provat, kushtëzohet nga objektivat që dëshironi të arrini gjatë kryerjes së ushtrimeve. Përcaktimi i këtyre objektiveve do të jetë përcaktues edhe për kohën, energjinë që do t'ju kushtoni provave. P.sh., nëse grupi vendos që pjesën ta shfaqë përpara një publiku të gjerë ose në një konkurs teatror, do t'ju duhet t'u kushtoni provave një kohë më të gjatë.

Ushtrime për dramatizimin

Provat

Nga ana tjetër, natyra e provave kushtëzohet nga hapësirat dhe mjetet që grupi ka në dispozicion. Nëse keni mundësi që të keni një farë skene, është gjëja më e mirë, por edhe nëse nuk e keni këtë mundësi, mund ta bëni në një hapësirë informale, të cilën duhet t'jua përshtatni kërkesava tuaja. Gjithësesi do të jetë grupi ai që do të vendosë përfundimisht për vendin ku do të zhvillohen rprovat.

Zhvillimi i provave kërkon durim dhe shpenzimin e shumë energjive. Për vetë natyrën që kanë, ato mund të jenë të gjata dhe të përsëriten shumë herë. Kështu, pas pak kohe të rinjtë do të fillojnë të mërziten. Gjithashtu, gjatë provave duhet të përqendroheni për kohë të pacaktuar në situata dhe personazhe të ndryshme. P.sh., mund të jetë një skenë patetike që edhe pse interpretohet vetëm nga dy personazhe, do t'ju kërkojë kohë të gjatë për t'u realizuar. Një problem tjetër është se çfarë duhet të bëjë pjesa tjetër e grupit gjatë kësaj kohe.

Kur të rinjtë mërziten dhe kanë kohë në dispozicion, ata duhet të shkarkojnë energjitë. Prandaj përgatituni edhe për këtë situatë. Nxitini që të marrin me vete topa për të luajtur, raketa pingpongu, libra dhe revista etj., në mënyrë që të kenë mundësi të merren me diçka gjatë kohës që nuk kanë prova. Gjithashtu, nxitini të kryejnë detyra të tjera në kohën e lirë, si, p.sh., detyrat e shkollës.

Një pjesë e grupit (nëse e parashikon skenari) mund të punojë për përgatitjen e skenës. Nëse keni vendsour të përdorni këngët, muzikën dhe vallet, duhet t'i përgatisin edhe ato. Diçka që duhet të dinë, është se gjatë provave, për arsye të ndryshme, mund të krijohen momente të tensionuara, pra, duhet të jeni të gatshëm t'i kapërcen dhe të shtensiononi situatën. Pra, para së gjithash, përgatituni t'i parandaloni dukuri të tilla.

Çelsi i sekretit për realizimin e provave në një klimë mirëkuptimi, veçanërisht me të rinjtë që e kanë për herë të parë, është krijimi i një klime të mirë komunikimi ndërmjet pjesëtarëve të grupit. Të rinjtë duhet të dinë saktësisht se ku duhet të shkojnë, ku duhet të ulen dhe çfarë duhet të bëjnë. Ata të dinë se çfarë duhet të thonë, si ta thonë dhe ku ta thonë. Të dinë se ku duhet të shkojnë, pasi të kenë thënë atë që duhet thënë. Nëse do të bëni një teatër të tipit të veçantë, p.sh., teatër me maska, duhet të saktësoni gjithçka dhe duhet t'ju shpjegoni gjithçka në vazhdimësi.

Është e rëndësishme që të rinjtë ta ndiejnë se ju u përgjigjeni menjëherë pyetjeve të tyre.

Metoda më e mirë për të ndihmuar aktorët e rinj është që skenari të jetë shumë i hollësishëm në shpjegime dhe regjitura shumë e vëmendshme. Është e rëndësishme t'i drejtosh aktorët duke u thënë, p.sh., kur është çasti që duhet të lënë skenën, mënyrën si duhet të veprojnë (me vrap apo duke u përbotur), duhet të dalin nga ana e majtë e skenës, ndoshta, duke shqiptuar batutën përfundimtare etj.

Mos nënvleftësoni energjitë që ju duhet të shpenzoni për provat, veçanërisht nëse keni një objektiv të veçantë dhe mosnënvleftësoni, gjithashtu, interpretimin cilësor të të gjithë grupit.

Përgatitja e shfaqjes dhe vetë shfaqja kushtëzohen nga objektivat që grupi i ka vënë vetes. P.sh., nëse dramatizimi është pjesë e një fushate me të gjerë ndëgjegjësuere, grupi do të vërë në jetë ato që ka mësuar gjatë zhvillimit të modulit për mjetet e komunikimit, për fazat e përgatitjes dhe të verifikimit, ndërsa ato çka janë mësuar në modulin e informimit dhe të integritetit të komunitetit, do të shërbëjnë për të theksuar impaktin që duhet të ketë fushata e ndëgjegjësisimit.

Përzgjedhja e tipit të shfaqjes që do të jepet, kushtëzohet nga një sërë faktorësh, si: koha kur do të shfaqet, hapësira që kanë në dispozicion, koha dhe baza materiale. Gjithashtu, është mirë që në caktimin e datës dhe të kohës së shfaqjes, të merren parasysh të gjitha rrethanat që do të mundësonin ndjekjen e saj nga një numër i ndjeshëm shikuesish. Gjithashtu, këto orare duhet t'i paraqiten edhe personelit të sallës, në mënyrë që të mënjanohet çdolloj keqkuptimi dhe që gjithçka të jetë gati në çastin e duhur.

Objektivi themelor i çdo shfaqjeje është që të sigurojë një ndikim sa më të fuqishëm në publikun e përzgjedhur. Për këtë duhet t'i njihni mirë karakteristikat e shikuesit. Vetëm nëse i njihni në thellësi karakteristikat e grupit tuaj, mund të realizoni shfaqje të përshtatshme. Faza e parë (e studimit) duhet të realizohet me seriozitetin dhe përkushtimin e duhur. Meqë të rinjtë janë autorët dhe realizuesit e projektit, ata duhet të përfshihen në të gjitha fazat.



Përgatitja e shfaqjes

Nëse vendosni të realizoni një shfaqje të hapur për të gjithë, duhet të merrni parasysh problemet e mëposhtme:

- **Biletat.** Kjo duhet nëse keni vendosur që shfaqjen të bëni me bileta; nëse ato duhet të shiten më parë apo ne kohën kur shikuesit do të hyjnë në sallë; nëse doni të vendosni një kuti në hyrje të sallës ku secili sipas dëshirës mund të japë ndonjë ndihmë.
- **Reklama.** Që në fillim vendosni në do t'i bëni reklamë shfaqjes; nëse do të përgatisni një fletëpalosje apo ta njoftoni shfaqjen nëpërmjet një posterit që do të ngjisni në vendin e lajmërimeve në lagjen tuaj etj.
- **Programi.** Po kështu, duhet paramenduar nëse do të botoni një program; nëse do të kërkonti ndonjë sponsor që do të mbulojë shpenzimet që ju janë nevojitur; nëse do të paguhet programi; nëse përgatitja e programit është një rast i mirë për të shënuar në të emrat e të gjithë të rinjve që kanë marrë pjesë në realizimin e dramatizimit, si dhe për të falenderuar dhe për të shkruar emrat e sponsorëve që kanë ndihmuar.



Realizimin e gjithçkaje që thamë më sipër, duhet ta bëni duke përfshirë të gjithë të rinjtë e grupit. Mos bëni shpenzime të kota, sepse nuk janë shumë të rëndësishme për qëllimin e projektit. Përdorini me zgjuarsuri burimet financiare që keni në dispozicion, dhe binduni që e vetmja gjë e rëndësishme është shfaqja. Të tjerat janë gjëra që mund t'i bëni ose jo.

Diçka tjetër që mund të bëni, është të filmoni shfaqjen, e cila mund të jetë e dobishme për shumë arsye:

- Nëse është pjesë e një serie shfaqjesh që do të jepni, filmimi mund t'ju ndihmojë të përmirësoni interpretimin në shfaqjet e mëpasme.
- Filmimi mund të përdoret për t'u dhënë nga televizione të ndryshme.
- Të rinjve dhe familjeve të tyre do t'u pëlqente të kishin një kopje të dramatizimit në shtëpitë e tyre si kujtim i punës dhe impenjimit të gjithësecilit për realizimin e saj.

- Filmimi mund të shërbejë si mjet didaktik për grupet e tjera.
- Gjithashtu, filmimi mund të përdoret si reklamë ndëgjegjësuere në fushatat për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.
- Mund t'i dërgohet IPEC-ut që të jetë pjesë e mjeteve të dokumentuara për fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjeluar

- Sigurohuni që ritmi i punës është i mirë, se të rinjtë përfshihen në realizimin e këtij ushtrimi.
- Sigurohuni që të gjithë të marrin pjesë.
- Përpikuni të mbani gjallë interesin si në fazën e shkrimit të skenarit, ashtu dhe gjatë provave; nëse bie interesi, grupi do të shkarkojë energjinë dhe imagjinatën e vet në drejtime të tjera.
- Mbështesni shkëmbimin e batutave brenda grupit si gjatë krijimit të skenarit, ashtu dhe gjatë provave. Sigurohuni që ky shkëmbim të bëhet me përzemërsi. Qëllimi është të rrisni besimin e të rinjve të vetja e tyre.
- Mos lejoni kritika të tepruara dhe përdorimin e një fjali të pakontrolluar. Krijimi i një klime antagonistike do të ulte ritmin e punës së grupit.
- Mos lejoni që një ri apo një grup i vogël të rinjsh të ndiehen të poshtëruar. Nëse mendoni se dikush ka vështirësi në të shkruar apo gjatë provave, ndihmoheni për të kapërcyer vështirësitë. Nëse dikush mbetet në mes të provave, ndërhyuni për të kapërcyer situatën ose, nëse është e nevojshme, të lërë skenën me dinjitet.
- Duhet të jeni të vëmendshëm ndaj ndonjë pjesëtari të grupit që ka ndonjë cen. Dramatizimi edhe për këta të rinj është shumë i rëndësishëm, sepse i ndihmon të kapërcejnë situata të vështira që u krijohen nga paaftësia që kanë. Kjo gjë është e vlefshme edhe për personat që mund të kenë përjetuar trauma të natyrës fizike dhe emocionale. Dramatizimi mund t'ju zgjojë përjetime të jetuara dhe është shumë e rëndësishme që ju t'i kuptoni këta të rinj dhe t'i ndihmoni. Në këto kushte, shumë e



rëndësishme është të krijoni marrëdhënie të mira, të hapura dhe miqësore edhe me prindërit dhe autoritetet e shkollës, në mënyrë që edhe ata të japin ndihmesën e tyre dhe të bashkëpunojnë.

- Nëse keni videokamera, përdorini. Është e dobishme në fazën e vlerësimit, madje edhe të rinjtë do të jenë të kënaqur të shohin veten e tyre të regjistruar.

Në fazën përfundimtare të modulit, gjatë vlerësimit, jepuni të rinjve të gjithë kohën e duhur që të shprehen lirshëm. Krijojini kushte që të çlodhen dhe qetësisht të mendojnë rreth koncepteve që përpunoni, dhe t'i përvetësojnë ato.

- Duhet të jeni ambiciozë për grupin tuaj, derisa edhe të rinjtë të bëhen të tillë. Puna e tyre dramatizuese do të ketë ndikimin e vet në njerëzit e tyre më të afërt, por dhe më tej. Realizimi me sukses e një nisme të marrë dhe të realizuar nga vetë të rinjtë, është një rrugë e mirë për të fituar besim në vetvete dhe vetëvlersim, si dhe të ndërgjegjësohen për rëndësinë dhe rolin e dramatizimit si zëdhënës i ndryshimit dhe të lëvizjes shoqërore për ndryshimin e gjendjes.


Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi

Ora e vlerësimit apo analiza përfundimtare e këtij moduli të zhvillohet pasi të jetë dhënë shfaqja. Për këtë, zgjidhni një mjedis të qetë. Analiza nuk duhet bërë kur grupi është emocionalisht i ngarkuar, p.sh., gjatë provave.

Mblidheni grupin dhe përmbledhni shënimet që keni marrë. Nëse jeni ndihmuar nga një person i jashtëm ose nga shumë persona, ftojini dhe ata të marrin pjesë në analizë. Këto module janë perceptuar në mënyrë të tillë që të ndërgjegjësojnë të rinjtë kundrejt problemit të punës së fëmijëve, duke intensifikuar dhe duke përfshirë hap pas hapi emocionalisht të rinjtë në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Nëpërmjet dramatizimit shtyhem në një nivel të ri të të kuptuarit, të ndjenja dhe qëndrimi ndaj problemit. Duke luajtur rolin e një fëmije, të rinjtë duhet të hyjnë në botën e personazhit, ta kuptojnë dhe të mbajnë qëndrim duke prodhuar ndjenja të caktuara dhe veprime. Pra, bëhet fjalë



për një metodë të të mësuarit të mrekullueshëm që do të ketë ndikim të rëndësishëm tek të rinjtë.

Moduli i dramatizimit, ndërmjet të gjitha moduleve që përmban ky projekt, është më i frytshmi që i ndihmon të rinjtë të kuptojnë dhe të ndiejnë se çfarë është puna e fëmijëve dhe cilat mund të jenë pasojat për fëmijët. Ai përmirëson nivelin e njohjes së të drejtave themelore të fëmijëve dhe përshpejton procesin e të qenit përgjegjës. Në përfundim të secilit modul, të rinjtë ndiejnë se janë rritur dhe dinë më shumë për problemin. Në këtë moment është e natyrshme që fillojnë të mendojnë se bëhet fjalë për një problem që të gjithë, në të gjithë botën, janë përgjegjës dhe kanë aftësi të luajnë një rol aktiv në fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Gjithashtu, fillojnë të kuptojnë forcën që ka dramatizimi në transmetimin e mesazhit shoqërisë. Nëpërmjet teatrit ata mund të arrijnë të gjitha shtresat e shoqërisë dhe të shpërndajnë mesazhin e tyre.

Të gjithë këta objektiva duhet t'u shpjegohen pjesëtarëve të grupit. Komunikoni me ta duke përdorur gjuhën e tyre, duke i motivuar dhe duke i nxitur. Jepuni të kuptojnë se fushata e luftës për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, ka nevojë për të gjithë dhe për ndihmën dhe pjesëmarrjen e tyre. Madje, mendohet se ndihma e të rinjve duhet të jetë shumë e fuqishme. Bëni të mundur që ata të ndjehen krenarë, ambiciozë dhe të mbushur me energji. Me këtë frymë duhet të përfundoni seancën e diskutimit përfundimtar. Ndiheja që duhet të japin të rinjtë, është më i veçantë se ai i grupeve të tjera, pasi në të bëhet fjalë për fëmijë, bashkëmoshatarë të tyre që punojnë.

Kjo seancë do t'i ndihmojë fëmijët të përmbledhin edhe një herë rëndësinë e asaj që kanë realizuar gjatë dramatizimit. Në këtë mënyrë do t'u japin rëndësinë e duhur të gjitha shfaqjeve që do të paraqiten më vonë. Është një përvojë shumë interesante të shohësh të rinjtë që interpretojnë dhe qëndrimin e publikut ndaj lojës së tyre. Duartrokitjet që do të marrin të rinjtë nga publiku, është shpërblimi më i madh dhe më i kënaqshëm që mund të prisni për të gjithë punën që keni kryer, pasi kështu ju keni ndihmuar në mënyrë të ndjeshme në fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Gjithashtu, përvoja e fituar do t'ju ndihmojë në realizimin e dramatizimeve me grupe të tjera fëmijësh dhe të rinjsh.

Vlerësimi dhe vazhdimi



Treguesit kryesorë të vlerësimit të modulit janë krijimi i një vepre skenike, vënia e saj në skenë dhe pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve të grupit. Gjatë gjithë kohës së realizimit të modulit është e rëndësishme të nxirren në pah rritja dhe ndërgjegjësimi i grupit, në përgjithësi, dhe i individëve të veçantë për rëndësinë e luftës ndaj punës së fëmijëve. Gjithashtu, është mirë të veçohen vetëvlersimi i të rinjve dhe besimi që fitojnë dora-dorës që zhvillohet moduli.

Dramatizimi është një mjet shumë i frytshëm për zhvillimin e aftësive të caktuara. Ai i ndihmon të rinjtë të formojnë idetë e tyre dhe të kuptojnë se çfarë ndjejnë dhe mendojnë për punën e fëmijëve, si dhe çfarë ndihmese mund të japin në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Ky modul ndihmon *veprimin*, një ndër elementet kryesore të fushatës. Nëpërmjet dhënies së shfaqjes, të rinjtë e grupit shndërrohen në veprimtarë të një ndryshimi shoqëror: edukojnë pjesëtarë të komunitetit, duke i ndihmuar të kuptojnë se përse duhet të ndryshojnë. Ndërmjet të tjerave i ndihmojnë të kuptojnë plagën e rëndë të punës së fëmijëve në të gjithë botën dhe nevojën e veprimit që duhet të ndërmerret për të ndihmuar fëmijët.

Është e rëndësishme të ruhen të gjitha shënimet apo dhe filmimet e bëra gjatë realizimit të këtij moduli, pasi me siguri ato do t'ju ndihmojnë në zhvillimin e modulit me grupet të tjera të rinjsh apo fëmijë.

Nëse përvoja e fituar gjatë realizimit të këtij moduli ka qenë pozitive, ju këshillojmë të vazhdoni me modulin "Integrimi i komunitetit", si fazën e mëtejshme të këtij procesi pedagogjik. Ndoshta do të mendoni se dramatizimi është pika kulmore e projektit, si dhe zbatimi praktik i shumë moduleve që keni bërë, por duhet të kujtoni se moduli i integritetit të komunitetit, është baza mbi të cilën janë ndërtuar të gjitha modulet.

Gjithashtu, mund të zhvilloni mendimin që të përfshihen në një fushatë të gjerë për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve nëpërmjet dramatizimit ose mund të zgjidhni të filloni gjithçka nga e para me një grup të ri. Pavarësisht vendimit që do të merrni, e rëndësishme është të mbani parasysh ndikimin që ka patur të fëmijët kjo përvojë që duhet në një farë mase të ketë ndryshuar jetën e tyre.

Shënime

Shënime